



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Qendra Trajnuese për Avokatë
Draft/Programi i trajnimeve 2022

**Ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve profesionale për Avokatët dhe
Praktikantët**

Përmbajtja

- Hyrje
- Qëllimi i programit
- Prioritetet e programit
- Programi i Arsimit të vazhdueshëm ligjor të obligueshëm
- Trajnimet në fushën penale
- Trajnimet në fushën civile
- Kushtetuese
- Nërcombëtare
- E drejta Evropiane
- Administrative
- Komerçiale
- Etika profesionale e Avokatëve
- Kurse speciale

Hyrje

Programi i Punës i Qendrës Trajnuese të Odës së Avokatëve të Kosovës (më tutje OAK), për trajnimin e avokatëve dhe praktikantëve të avokatisë për vitin 2022, shpreh synimet tona drejtë realizimit të arsimimit të vazhduar ligjor për avokatë. Për OAK-në viti 2021 ishte periudhë e sfidave por edhe e mundësive të shumta. Programi i Punës së OAK-së për vitin 2022 është reflektim i nevojave për mbështetje të reformave gjithëpërfshirëse të avokaturës dhe mbështetje në tejkalimin e sfidave për zbatim e Ligjit për Avokatinë dhe legjislacionin tjetër të OAK-së.

Për realizimin e këtij programi të Trajnimit, QTA ka marrë për bazë:

- Pyetësorin për vlerësimin vjetor të nevojave trajnuese i shpërndarë tek të gjithë avokatët.
- Formularët e vlerësimit të trajnimeve të organizuara nga QTA/OAK.
- Takimet me trajnuesit e QTA/OAK.
- Takimet e rregullta me drejtuesit e Zyrave Regjionale të OAK-së.
- Rekomandimet e komiteteve të OAK-së.

Realizimi i objektivave të këtij programi do të bëhet duke u mbështetur në parime të transparencës, mosdiskriminimit, pavarësisë institucionale, profesionalizimit, bashkëpunimit, zbatimit të ligjit si dhe standardeve më të larta të përcaktuara për arsimimin e vazhduar ligjor për avokatët.

Bazuar në funksionet ligjore të OAK-së, janë hartuar programe trajnimi të veçanta të cilat mbështesin këtë program pune. Me këto programe janë përcaktuar aktivitetet konkrete dhe metodologjia e realizimit të tyre.

Nëpërmjet këtij programi pune, do të pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur angazhimi i OAK-së për realizimin e programeve të veçanta trajnuese dhe aktiviteteve tjera për vitin 2022.

1. Qëllimet e Programit të Trajnimeve

Disa nga qëllimet kryesore të cilat synohen të arrihen me programin e trajnimit për vitin 2022, janë:

- Ngritja e vazhdueshme profesionale e avokatëve;
- Përgatitja profesionale e praktikantëve të avokatisë;
- Zbatimi i trajnimeve të specializuara për avokatë;
- Zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë në fushën e trajnimeve;
- Zhvillimi i një metodologjie moderne gjatë zbatimit të programeve trajnuese;
- Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme për arsimimin ligjor të karakterit ndërkombëtarë.
-

2. Prioritetet e Programit të Trajnimeve

Realizimi i aktiviteteve trajnuese do të bëhet mbi bazë të prioriteteve të përcaktuara me programin vjetor të punës për vitin 2019, duke pasur parasysh edhe kapacitetet administrative, profesionale dhe financiare të OAK-së.

Renditja e prioriteteve programore, sipas rëndësisë së tyre, bëhet si më poshtë:

- Arsimimi i Vazhdueshëm Ligjor i Obligueshëm për Avokatë;
- Programi Gjithëpërfshirës për Praktikantë;
- Organizimi i Provimit të Etikë për Avokatë/ Provimi hyrës për Avokatë të huaj
- Programi për Trajnimet e Jurisprudencës;
- Hulumtime dhe Publikime.

3. Programi i Arsimimit të Vazhdueshëm Ligjor të Obliguar (AVLO)

Përmbajtja e AVLO për vitin 2021 shpreh nevojat e avokatëve bazuar në pyetësin e trajnimeve për vlerësimin e nevojave të anëtarësisë.

Programi i AVLO-së është hartuar nga ekspertë të ndryshëm, trajnues të OAK-së dhe nga stafi i OAK-së.

Ai bazohet në nevojat e shprehura nga përfituesit e tij si dhe është përmbledhur duke përdorur teknika dhe metodologji të veçanta të cilat kanë mundur një program gjithëpërfshirës dhe të llojllojshëm.

3.1 OBJEKTIVAT e AVLO -së

Në përmbushje të nevojave dhe pritjeve për një avokati me integritet të lartë profesional, etike, të paanshme, të pavarur dhe moderne, AVLO ka këto objektiva:

- Arsimim Ligjor për Avokatët lidhur me reformat legjislative si dhe zhvillimet në praktikën e Avokatisë;
- Ofrimi i mbështetjes profesionale avokatëve në punën e tyre praktike;
- Nxitja e shkëmbimit të njohurive, metodave dhe praktikave më të mira profesionale;
- Forcimi i shkathhtësive profesionale të shkrimit, arsyetimit dhe argumentimit gjatë zbatimit të ligjit në praktikë;
- Dhënia e kontributit për mbajtjen e avokatëve të informuar për zhvillimet në lëmin e jurisprudencës, ekonomik, social dhe kulturor;
- Ngritja e njohurive të avokatëve rreth të drejtës ndërkombëtare në veçanti të së drejtës evropiane;
- Ofrimi i një qasje multidisiplinare për TEMAT apo çështjet e adresuara nga nevojat për trajnim të avokatëve;

3.2. Përmbajtja e AVLO-së

AVLO për vitin 2022, përmban në vete për trajtim çështje nga:

- E drejta penale (materiale, procedurale dhe ekzekutimi i sanksioneve penale);
- Drejtësia për të mitur;
- E drejta civile (materiale dhe procedurale);
- E drejta administrative;
- E drejta e punës;
- E drejta kushtetuese;
- Etika profesionale dhe sistemi disiplinor;
- Kurse të specializuara (përfshirë zhvillimin e shkathtësive të veçanta të avokatëve).

3.3. Burimet për hartimin e AVLO

Me qëllim që AVLO t'u përgjigjet nevojave të avokatëve për trajnim janë përdorur burimet e poshtëshënuara:

- Analiza e formave të vlerësimit të aktiviteteve trajnuese të organizuara në vitin 2021;
- Përgjigjet e pyetësorëve të dërguara avokatëve me qëllim të propozimit të temave për trajnim për vitin 2022;
- Takime me anëtarësinë në regjione dhe Kryetarët e Degëve Regjionale;
- Propozimet e grupit të ekspertëve të caktuar ad-hoc, për hartim të programeve trajnuese;
- Diskutimet me avokatët;
- Propozimet e trajnuesve të OAK-së të dhëna në takime të veçanta gjatë vitit 2021;
- Propozimet e donatorëve/partnerëve të ndryshëm të cilët mbështesin OAK-në.

3.4. Përfituesit

Përfitues të trajnimeve dhe aktiviteteve të QTA-së, janë:

- Avokatët;
- Praktikantët;
- Profesionistët e tjerë ligjor të përcaktuar nga OAK.

1. TRAJNIMET NË FUSHËN PENALE

1.1. PARABURGIMI STANDARDET VENDORE DHE TË GJEDNJ

HYRJE:

Liria e lëvizjes është kategori kushtetuese e cila mund të kufizohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Po ashtu liria e lëvizjes është objekt i rregullimit në Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut (neni 5). Duke marr parashysh rëndësinë që e ka kjo e drejtë në lidhje me të, GJEDNJ ka nxjerr një numër të madh të vendimeve në të cilat konstatohet shkelja e kësaj të drejte. Neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se të drejtat e njeriut duhet të interpretohen në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, prandaj trajtimi i jurisprudencës së GJEDNJ-së ka një rëndësi të veçantë për avokatët Kosovarë. Meqenëse kjo dispozitë nga neni 53 i Kushtetutës së vendit detyron institucionet publike që interpretimin e dispozitave ligjore të vendit ta bëjnë sipas standardeve të GJEDNJ-së, kjo do të mundësonte që zbatim praktik i legjislacionit të jetë në harmoni me standardet e GJEDNJ-së, e kjo do të mundësonte zbatimin e detyrimit kushtetues.

OBJEKTIVAT:

Pjesmarrësit e këtij trajnimi në fund duhet të arrijnë këto objektiva:

- 1) Të kuptojnë rëndësinë e kufizimit të lirisë së lëvizjes,
- 2) Të kuptojnë jurisprudencën e GJEDNJ-së, në lidhje me shkeljet e kësaj të drejte
- 3) Të jenë në gjendje që në praktikë të zbatojnë standardet e përcaktuara në vendimet e GJEDNJ.
- 4) Të kuptojnë aplikimin e legjislacionit vendor sipas standardeve të GJEDNJ-së.

TEMAT:

1.1.1. Nocioni kushtetues i lirisë së lëvizjes

1.1.2. Kufizimi i lirisë së lëvizjes dhe prezumimi i pafajësisë

1.1.3. Arsyeimi i vendimeve gjyqësore me të cilat kufizohet liria e lëvizjes

1.1.4. Baza ligjore e kufizimit të lirisë së lëvizjes

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikant.

1.2. VLERA PROVUESE E MARRJES NË PYETJE DHE MARRJES SË DEKLARATËS NË PROCEDURËN PARAPRAKE

HYRJE:

Vlera provuese e veprimeve hetimore në shqyrtimin gjyqësor është e një rëndësie të madhe sepse në të shumtën e rasteve këto veprime mund të jenë edhe përcaktuese për rrjedhën dhe epilogun e një rasti penal. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës në mënyrë të qartë ka përcaktuar dallimet në lidhje me vlerën provuese të marrjes në pyetje dhe deklaratës në procedurën paraprake. Në këtë drejtim ligjvënësi ka përcaktuar se marrja në pyetje në procedurë paraprake mund të përdoret si provë vetëm për nevojat e procedurës hetimore, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor mund të përdoret vetëm për ekzaminimin e tërthortë të dëshmitarit por jo edhe si provë e drejtëpërdrejtë. Për dallim të këtij veprimi hetimor, deklarata në procedurë paraprake mund të përdoret edhe si provë e drejtëpërdrejtë në shqyrtimin gjyqësor nëse prokuroria e siguron këtë provë në mënyrën e përcaktuar me ligj. Në praktikë është vërejtur se institucionet e zbatimit të ligjit nuk e kanë bërë një dallim të qartë në zbatimin e këtyre dy instituteve. Për rrjedhojë trajtimi i këtyre dy instituteve është me rëndësi për avokatët kosovarë.

OBJEKTIVAT:

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi do të arrijnë këto objektiva:

- 1) Të kuptojnë vlerën provuese të veprimeve hetimore
- 2) Të kuptojnë rëndësinë procedurale të marrjes në pyetje dhe deklarimit në procedurën paraprake
- 3) Të kuptojnë dallimet në mes të marrjes në pyetje dhe deklarimit në procedurën paraprake në aspektin e vlerës provuese në shqyrtimin gjyqësor.

TEMAT:

1.2.1. Kuptimi i vlerës provuese të veprimeve hetimore

1.2.2. Marrja në pyetje

1.2.3. Deklarimi në procedurën paraprake

1.2.4. Dallimet në vlerën provuese

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe praktikantët

1.3. APLIKIMI I UDHËZUESIT PËR POLITIKA NDËSHKIMORE NGA PRIZMI I AVOKATIT

HYRJE:

Harmonizimi i politikës ndëshkimore është problem i vazhdueshëm me të cilin ballafaqohen gjykatat në rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës e gjendur në një situatë të tillë ka miratuar udhëzuesin për politikën ndëshkimore me qëllim të harmonizimit të politikës ndëshkimore dhe trajtimit të barabartë të kryesve të veprave penale. Trajtimi i kësaj teme nga prizmi i avokatëve mbrojtës është i rëndësishëm me që njohuritë e tyre do të i zbatojnë në rastin e propozimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese në rastet kur përfaqësojnë të akuzuarit dhe palën e dëmtuar në procedurë penale. Gjykata Supreme poashtu ka miratuar edhe udhëzuesit specifik për politikën ndëshkimore në raport me dënimet me gjobë dhe veprat penale kundër detyrës zyrtare dhe korrupsionit, për të cilat gjithashtu është e nevojshme që të kuptohet metodologjia e aplikimit nga gjykata që mundëson për mbrojtës që ata të kuptojnë faktorët që ndikojnë në politikën ndëshkimore por që mbrojtësit do të kenë mundësi që ta kuptojnë edhe parashikueshmërinë e sistemit të politikës ndëshkimore sipas këtyre udhëzuesve specifik.

OBJEKTIVAT:

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi në fund duhet të arrijnë këto objektiva:

- 1) Të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e aplikimit të udhëzuesit për politikën ndëshkimore
- 2) Të zbatojnë propozimet për rrethanat lehtësuese dhe rënduese
- 3) Të kuptojnë rolin e unifikimit të praktikës gjyqësore
- 4) Të kuptojnë metodologjinë e aplikimit dhe rrethanat që ndikojnë në dënim sipas udhëzuesve specifik

TEMAT:

1.3.1. Parimet e udhëzuesit për politikën ndëshkimore

1.3.2. Mundësitë e aplikimit të udhëzuesit nga këndvështrimi i avokatit

1.3.3. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese

1.3.4. Parimet e udhëzuesve specifik

Kohëzgjatja e trajnimit: dy ditore

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikant.

1.4. PROCEDURA PËRGADITORE NË PROCEDURËN PËR TË MITUR

HYRJE:

Procedura penale ndaj kryesve të mitur për dallim nga kryesit madhorë rregullohet me kod të veçantë si rrjedhojë shfaqet edhe dallimi sa i përket fazës hetimore (përgaditore). Në procedurë për të miturit si njëra ndër fazat më të rëndësishme është procedura përgaditore në të cilën procedurë sigurohen provat mbi të cilat ndërtohet çështja penale ndaj të miturit. Roli i avokatit gjatë kësaj procedure është shumë i rëndësishëm pasi që gjatë kësaj faze mund të propozojë nxjerrjen e provave që shkojnë në favor të të miturit dhe nga të cilat përcaktohet e gjithë çështja.

OBJEKTIVAT:

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi në fund të trajnimit duhet të arrijnë këto objektiva:

- 1) Të kuptojnë mundësinë e shtrirjes së veprimeve të tyre në këtë fazë të procedurës
- 2) Të kuptojnë se cilat veprime mund të ndërmerren gjatë kësaj faze
- 3) Mundësinë e shqiptimit të masave të diversitetit ndaj të miturve

TEMAT:

1.4.1. Parimet e procedurës ndaj të miturve

1.4.2. Dallimet e procedurës përgaditore dhe hetimore ndaj të miturve

1.4.3. Masave të diversitetit si alternativë

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditore

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikant.

1.5. PROCEDIMI I PERSONAVE ME ÇREGULLIME MENDORE

HYRJE:

Personat me çregullime mendore janë kategori e veçantë e kryesve të veprave penale, për këtë arsye KPP ka përcaktuar dispozita specifike të rastet kur këta persona përfshihen në kryerjen e veprës penale.

Trajtimi i këtyre rasteve kërkon kujdes të veçantë për shkak të gjendjes mendore të kryesve në momentin e kryerjes së veprës penale, specifikisht është e rëndësishme të trajtohet aspekti i kufizimit të lirive të këtyre personave dhe aspekti i shqiptimit të masave të detyrueshme të trajtimit dhe të ekzekutimit të këtyre masave.

OBJEKTIVAT:

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi në fund duhet të arrijnë këto objektiva:

- 1) Të kuptojnë rëndësinë dhe specifikat e procedurës penale kur përfshihen personat me çregullime mendore
- 2) Të vlerësojnë rastet kur caktohet paraburgimi të personat me çregullime mendore
- 3) Të analizojnë masat për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik si dhe ekzekutimin e tyre

TEMAT:

1.5.1. Parimet e e procedurës penale të personave me çregullime mendore

1.5.2 Roli i mbrojtësit në procedurën ku përfshihen personat me çregullime mendore

1.5.3 Roli i mbrojtësit në përcaktimin e masës së paraburgimit

1.5.4. Roli i mbrojtësit në shqiptimin dhe ekzekutimin e masës së trajtimit të detyrueshëm

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët.

1.6. PRANUESHMËRIA DHE RELEVANCA E PROVAVE

HYRJE

Në procedurën e provave gjykata është e obliguar që në mënyrë të drejtë dhe të plotë të i vërtetojë faktet të cilat janë me rëndësi për marrjen e një vendimi të ligjshëm. Qëllimi i procedurës penale është vërtetimi i fakteve ngase vetëm me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të fakteve mund të bazohet vendimi i provave. Për vërtetimin e fakteve të cilat janë me rëndësi për marrjen e vendimit gjykata i ka në dispozicion mjetet provuese, por se çka do të konsiderohet se është vërtetuar në procedurën penale e vendos gjykata me vendimet e saj.

Marr parasysh atë që u tha më lartë pranueshmëria e provave është një segment shumë i rëndësishëm i gjykimit të drejtë. Kjo për faktin se gjykata duhet të bazojë vendimin e saj vetëm në provat të cilat janë marr në procedurën e paraparë me ligj. Duke qene se mbrojtësit në procedurë penale shpesh herë kanë interesin për të nxjerrë prova që konsiderojnë se janë të nevojshme dhe të arsyeshme për pretendimet e mbrojtjes, relevanca e provave do të mundësonte që mbrojtësit të ngrisin aftësit e tyre profesionale në kuptim të argumentimit të propozimeve për faktet relevante apo rrethanore, në procedurë penale që si të tilla ato propozime të gjejnë përkrahje nga gjykatat.

OBJEKTIVAT:

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi në fund të trajnimit duhet të arrijnë këto objektiva:

- 1) Të kuptojnë rëndësinë e mjeteve provuese në procedurën penale
- 2) Fazat e procedurës në të cilat gjykata kujdeset për pranueshmërinë e provave
- 3) Procedurën e shpalljes së një prove si provë e pa pranueshme
- 4) Te kuptojnë standardet ligjore të pranueshmërisë së provave

TEMA :

- 1.6.1. Parimet e përgjithshme të të provuarit në procedurën penale
- 1.6.2. Provat të cilat ex lege konsiderohen të papranueshme
- 1.6.3. Provat të cilat sigurohen në shkelje të të drejtave të garantuara me kushtetutë
- 1.6.4. Materialet të cilat rrjedhin nga provat e papranueshme
- 1.6.5. Kushtet ligjore të pranueshmërisë dhe shpallja e papranueshme e provave që janë në kundërshtim me dispozitat ligjore
- 1.6.6. Argumentimi i propozimit për relevancë të provës në raport me faktet

Kohëzgjatja e trajnimit: Dy ditor

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikant.

1.7. CAKTIMI I MASAVE DHE DËNIMEVE SIPAS KDM

HYRJE:

Me qëllim të realizimit të interesit më të mirë të miturit të kryesit të veprës penale ligjvënësi përmes KDM ka paraparë masa dhe dënime që dallojnë nga kryesi madhor. Sistemi i

drejtësisë për të mitur e synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që reagimi ndaj të miturve të jetë në proporcion me rrethanat e kryerjes së veprës penale.

OBJEKTIVAT:

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi në fund të trajnimit duhet të arrijnë këto objektiva:

- 1) Të kuptojnë rëndësinë e shqiptimit të llojit të lartësisë së masave dhe dënimit ndaj të miturit
- 2) Të kuptojnë llojet e Dënimeve
- 3) Roli i mbrojtësit në përcaktimin e masave dhe dënimeve në procedurë për të mitur
- 4) Roli i mbrojtësit në determinimin e rrethanës në rastin e marrjes së vendimit të masave dhe dënimit për të mitur.

TEMAT:

1.7.1. Llojet e masave

1.7.2 Dënimeve ndaj të miturve

1.7.3. Ekzekutimi i masave dhe dënimeve

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikant.

1.8. PARIMET E GJYKIMIT TË DREJTË DHE TË PAANSHËM NË PROCEDURËN PENALE (NENI 6 I KEDNJ)

HYRJE

Garantimi i Lirive dhe të Drejtave Themelore të Njeriut në Republikën e Kosovës, aplikohet përmes mekanizmave ligjor vendor dhe atyre ndërkombëtarë. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, konform nenit 22 dhe 53 ka përcaktuar zbatimin në mënyrë direkte të Konventave ndërkombëtare në Republikën e Kosovës.

Neni 6 garanton të drejtën për një proces të drejtë dhe të hapur në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile të një individi ose të ndonjë akuze penale kundër tij.

Neni 6 KEDNJ ka paraparë të drejtën e shtetasve për t'u dëgjuar drejtësisht, publikisht dhe mbrenda afatit të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj. Gjithashtu janë përfshirë mbrojtja e këtyre të drejtave dhe atë: prezumimit të pafajësisë, të drejtën për t'u ndëgjuar publikisht, të drejtën e qasjes në drejtësi, barazinë e palëve në

procedurë, të drejtën për t'u informuar në gjuhën që ai e kupton, të drejtën për t'u mbrojtur vetë apo me ndihmën e mbrojtësit, apo t'i sigurohet mbrojtja kur i pandehuri-i dëmtuari nuk ka mjete të mjaftueshme.

Trajnimi i sotëm do të fokusohet në elaborimin e procesit të rregullt gjyqësor si në procedurën civile dhe atë penale dhe ky trajnim ka qëllimin tonë që të sigurohemi që avokatët me veprimet e tyre juridike në proceset gjyqësore (e që e luajnë një rol vendimtarë), do të mund të siguronin se gjatë gjithë procedurës së zhvilluar gjatë mbrojtjes, do të jenë në përputhje me detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në bazë të Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, paragrafi 1, 2, 3 (a,b,c,d,e).

OBJEKTIVAT e trajnimit

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të identifikojnë Parimet e përgjithshme të Nenit 6 KEDNJ
- Të njoftohen me mbrojtjen procedurale konform nenit 6 paragrafi 1, 2 dhe 3 (a,b,c,d,e)
- Të avancojnë njohuritë lidhur me praktikën e tanishme të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut GJEDNJ lidhur me nenin 6 të KEDNJ
- Të evidentojnë problematikat gjatë realizimit të kërkesave ligjore në funksion të një procesi të rregullt gjyqësor.
- Të zbatojnë në praktikë nocionin e një "procesit të drejtë".

Rëndësi do t'i kushtohet disa rasteve praktike të GJEDNJ nga neni 6 KEDNJ

TEMAT:

- 1.8.1. E drejta për gjykim nga një Gjykatë e paanshme dhe e themeluar me ligj,
- 1.8.2. Barazia e armëve,
- 1.8.3. Parimi I kontradiktoritetit,
- 1.8.4. Gjyrimi brenda afatit të arsyeshëm
- 1.8.5. Të drejtat e të pandehurit në procedurën penale
- 1.8.6. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

1.9. PROCEDURAT NË DHOMAT E SPECIALIZUARA

HYRJE

Aktualisht, arsimimi juridik i avokatëve për përfaqësime në nivel ndërkombëtarë është i domosdoshëm. Përvoja e pakët, debati dhe literatura e varfër juridike, mungesa e familjarizimit me të drejtën ndërkombëtare e evropiane, kapacitetet financiare të pamjaftueshme janë disa nga problemet më kryesore me të cilat përballet sot arsimi juridik i avokatëve.

Dhomat e Specializuara funksionojnë bazuar në një kuadër juridik i cili esencialisht dallon nga procedura penale e cila zhvillohet në gjykatat kosovare.

Dallimet mund të vërehen edhe me një shikim të thjeshtë të transmetimeve televizive të seancave gjyqësore në Dhomat e Specializuara të cilat flasin për veprime procedurale të cilat janë të panjohura për sistemin tonë procedural.

Një numër i madh i avokatëve kosovar janë të licencuar për të ofruar shërbime për personat e dyshuar/akuzuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Për të ofruar shërbime sa më kualitative të cilat janë në harmoni me parimet e një mbrojtje efektive, avokatët kosovar duhet të trajnohen specifikisht për zbatimin e kuadrit ligjor të Dhomave të Specializuara.

Deri më tani nuk është organizuar asnjë trajnim i vetëm për avokatët të cilët potencialisht mund të përfaqësojnë klientët e tyre pranë Dhomave të Specializuara.

OBJEKTIVAT:

- Të identifikojmë dallimet në mes të Rregullores së Procedurës dhe Provave të DH.S në raport me KPPRK-në specifikisht në;
- Fazën e hetimit
- Konfirmimit të aktakuzës
- Përgaditjes së shqyrtimit gjyqësor dhe
- Shqyrtimit gjyqësor
- Të kuptojmë dallimet në menaxhimin e çështjeve gjyqësore;
- Të kuptojmë dallimet në kulturën juridike etj.

TEMAT:

1.9.1. Faza e hetimeve në Dhomat e Specializuara

1.9.2. Faza e konfirmimit të aktakuzës

1.9.3. Konferencat statusore

1.9.4. Shqyrtimi kryesor

1.9.5. Dallimet esenciale në mes të rregullave të procedurës dhe KPPRK-së në lidhje me fazat e lartëcekura.

Kohëzgjatja: Dy ditore

Pjesëmarrësit: Avokatët dhe praktikantët

1.10. VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT ZYRTAR DHE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE

HYRJE:

Veprat penale të korrupsionit zyrtar dhe kundër detyrës zyrtare janë vepra mjaftë të përhapura por që shpesh herë nga aspekti praktik kanë problematika të mëdha në definimin e saktë të identifikimit të formave të kryerjes elementeve të figurës së këtyre veprave penale, fakti se shpesh herë ka vepra penale që konsiderohen të konsumuara me një veprim ndërsa sërish I ngarkohen kryerësit edhe vepra nga ky kapitull, që do të thotë aspekti I konsumimit të veprimeve inkriminuese dhe të përgjegjësisë në raport me veprat konkrete penale të këtij kapitulli. Poashtu në kuptimin e provueshmërisë duke pasur për bazë posaçërisht elementin subjektiv këto vepra krijojnë shpesh herë dualizma të interpretimeve ligjore nga gjykata, andaj përmes trajtimit të tyre, avokatëve do tu mundësohet që ti ngrisin kapacitetet profesionale për të pasur mundësi që ti qasen lehtësisht praktikës gjyqësore dhe njëkohësisht për të shmangur mundësit e përgjegjës së dyfishtë për të mbrojturit e tyre. Rëndësi të veçantë në raport me disa nga këto vepra ka të bëjë edhe dallimi në raport me aspektet e përgjegjësive disiplinore dhe kur ato konsiderohen vetem si veprime administrative dhe kur mund të konsiderohet se kemi të bëjmë me përgjegjësi penale.

OBJEKTIVAT:

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi në fund të trajnimit duhet të arrijnë këto objektiva:

- 1) Të definojnë qartë format e kryerjes dhe elementet e këtyre veprave penale
- 2) Të kuptojnë të provuarit e këtyre veprave penale

3) Të bëjnë dallimin e bashkimit ideal dhe real fiktiv te këtyre veprave brenda këtij kapitulli

TEMAT:

1.10.1. Vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe autoritetit

1.10.2. Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokuroimin publik

1.10.3. Marrja dhe dhënia e ryshfetit

1.10.4. Mashtrimi në detyrë

1.10.5. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët.

1.11. FORMAT E BASHKËPUNIMIT NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE

HYRJE

Kodi penal i Republikës së Kosovës ka paraparë përgjegjësinë penale në situatën kur në kryerjen e veprës penale marrin dy apo më shumë persona, qoftë si kryes apo kontribues në kryerjen e veprës penale. Rëndësia e trajtimit të kësaj teme qëndron në faktin se në praktikë shpesh herë janë paraqitur probleme në rastet kur në kryerjen e veprës penale marrin pjesë më shumë se një person, duke identifikuar qartë veprimin e secilit nga ta dhe kufijtë e përgjegjësisë penale

OBJEKTIVAT:

Pjesëmarrësit e këtij trajnimi në fund të trajnimit duhet të arrijnë këto objektiva:

1) Të dallojnë format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale

2) Analizojnë rastet kur bëmi të bëjmë me rastet e bashkëkryerjes, shtytjes dhe ndihmës së kryerjes së veprës penale.

3) Të analizojmë rastet kur kemi të bëjmë me bashkim kriminal

TEMAT:

1.11.1. Format e bashkëpunimit si bashkëkryerja, ndihma, bashkimi kriminal, shtytja

1.11.2. Roli i avokatit në përcaktimin e përgjegjësisë së bashkëkryerjes

1.11.3. Kufijtë e përgjegjësisë penale dhe matja e dënimit të format e bashkëpunimit.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët dhe avokatët praktikant.

1.12. TË DREJTAT E VIKTIMAVE SIPAS LEGJISLACIONIT NË FUQI

HYRJE:

Duke qenë se në procedurë I dëmtuari shfaqet si palë në procedurë ku gëzon të drejta të caktuara në aspektin procedural dhe material, përmes trajtimit të kësaj teme Avokatat do të jenë në gjendje që të ngrisin kapacitetet profesionale për tu dhënë këshillat e duhura viktimave, duke filluar nga fazat e hershme të procedurës penale e deri në perfundimin e saj. Kjo do të konsistonte me theks të veçantë të këshillimeve lidhur me mundësit e ofrimit të provave që të realizoj kërkesën e dëmit në procedurë penale parashtrimin e deklaratave të dëmit por edhe mundësit e shfrytëzimit të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, duke e këshilluar viktimën që për veprat që lejon ligji të udhëzohet dhe këshillohet për parashtrimin e kërkesës, mundësit e realizimit të kompensimit nga fondi për kompensimin e viktimave.

OBJEKTIVAT:

1. Të kuptojmë rolin e viktimave në procedurë penale
2. Të kuptojmë te drejtat e viktimave për të qenë aktiv në realizimin e kërkesës pasurore juridike,
3. Të kuptojmë mundeit e kompensimit sipas legjislacionit për kompensimin e viktimave.

TEMAT:

- 1.12.1. Të drejtat e viktimave në secilën fazë të procedurës penale,
- 1.12.2. Roli I viktimave në paraqitjen e provave që ndërlidhen me fajsinë e kryersit,
- 1.12.3. Roli I viktimave në paraqitjen e kërkesës për dëmin dhe provave për kërkesën pasurore juridike,
- 1.12.4. Të drejtat e viktimave sipas ligjit për kompensimin e viktimave.

Kohëzgjatja: Një ditë

Pjesmarrësit: Avokatët dhe avokatët praktikant

1.13. SHKRESAT NË PROCEDURË PENALE DHE PËRGATITJA E PARASHTRESAVE TË AVOKATIT

HYRJE:

Kodi i procedurës penale ka përcaktuar disa kufizime lidhur me njohjen e mbrojtjes dhe pranimin e shkresave në procedurë penale varësisht nga zhvillimi I fazës së hetimeve, si dhe varësisht nga rrethanat e çështjes dhe konfidencialiteti I materialit provues perkatësishte shkresave në procedurë penale. Rëndësia e kësaj teme vë theksin që paisja me shkresa të lëndës në fazën sa me të hershme të procedurës penale ndërlidhet me dhënien e mbrojtjes cilësore dhe efektive ndaj të dyshuarit në procedurë penale gjë që është detyrim etik dhe ligjor I avokatit që mbrojtjen ta parashtroj në mënyrë profesionale dhe efikase. Andaj kjo temë do të ngris aspektin e njohurive të avokatëve për të drejtat dhe mënyrat e sigurimit të shkresave në procedurë penale, për të mundësuar edhe përgatitjen e mbrojtjes ne raport me të akuzuarit. Duke qenë se shkresat në procedurë penale shpesh herë ndërlidhen edhe me fazat e ndryshme të procedurës penale, kjo do të krijonte mundësin që avokatët të jenë në gjendje që të përgadisnin parashtrësat në procedurë penale duke qene si të tilla koncize të mbështetura lehtësishtë të identifikueshme pretendimet e mbrojtjes, në mënyrë që gjykata të mund saktësishte të jap arsyetimet e saja lidhur me pretendimet e avokatëve.

OBJEKTIVAT:

1. Të kuptojmë paisjen me shkresat e lëndës në raport me fazat e procedurës penale;
2. Të kuptojmë të drejtat dhe rëndësin e mbrojtësve për paisjen me shkresat e lëndës;
3. Të kuptojmë rëndësin e hartimit kualitativ në parashtrësata duke përdorur standardet gjuhësore.

TEMAT:

1.13.1. Paisja me shkresat e lëndës në fazën e hetimeve;

1.13.2. Paisja me shkresat e lëndës pas ngritjes së aktakuzës;

1.13.3. Përpilimi i parashtrësave si, propozimet, kundërshtimet, ankesat dhe kërkesat për mjete të jashtëzakonshme.

Kohëzgjatja: Një ditë

Pjesëmarrësit: Avokatët dhe avokatët praktikant

2. TRAJNIMET NË FUSHËN CIVILE

1. MBROJTJA E TË DREJTËS SË PRONËSISË

HYRJE

Në këtë sesion do të jepen shpjegime lidhur me mbrojtjen e pronësisë si e drejtë subjektive karakterit absolut. Mbrojtja e pronësisë në të gjitha sistemet juridike është e garantuar, e gjithashtu kjo e drejtë mbrohet edhe me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (KEDNJ), Protokolit 1, përmes padive. Gjatë këtij moduli të trajnimeve do të jepen shpjegime lidhur me këto lloje të padive, tipike për mbrojtjen e pronësisë, si dhe legjitimiteti për ngritjen e këtyre padive. Te padia e reivindikimit duhet të provoj paditësi ndaj personit (paditurit) që ka posedimin e sendit dhe poseduesi çfarë kundërshtime mund të përdor. Dallimi në mes të padive për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë dhe mbrojtjes së posedimit.

Cilat janë karakteristikat e padisë publiciane, kush ka drejtë të ngritë, si provon drejtën paditësi dhe çfarë kundërshtime ka të drejtë të provoj i padituri, a parashkruhet e drejta për ushtrimin e kësaj padie.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij sesioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të kuptojnë rëndësin e mbrojtjes së pronësisë;
- Të shpjegojnë llojet e këtyre padive;
- Pjesëmarrësit të bëjnë dallime në mes këtyre padive;
- Rëndësia e nenit 1 të Protokolit 1 të Konventës Evropiane mbi mbrojtjen e drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- Praktikën gjyqësore për këto padi.

Kohëzgjatja e trajnimit: një ditë

Përfituesit: Avokatët

1.2. MËNYRAT E FITIMIT TË TË DREJTËS SË PRONËSISË, ME THEKS TË VEÇANTË ME PARASHKRIM FITUES

HYRJE

Pronësia është një e drejtë transferueshme, për kalimin e saj nga një pronar në person tjetër është e domosdoshme që të vërtetohet një fakt juridik (një shkak juridik). Transferimi apo kalimi i pronësisë tek personat tjerë bëhet kryesisht me vullnetin e pronarit, si me kontratë shitjes, dhurimit apo mënyrave tjera, por mund të bëhet edhe pa vullnetin e pronarit me pushtimin e sendit, me shpronësim, me parashkrim fitues etj. Një prej mënyrave të fitimit të të drejtës së pronësisë në mënyrë origjinere është parashkrimi fitues, për të cilën duhet të plotësohen kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë sipas kësaj baze. Dilemat në praktikën gjyqësore janë ato se si llogariten afatet dhe vlerësimin e mirëbesimit të poseduesit të sendit.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij sesioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të shpjegojnë mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë;
- Të aplikojnë në praktikë rastet që kanë të bëjnë me mënyrat e fitimit të drejtës së pronësisë;
- Të kuptojnë kushtet për fitimin e të drejtës së pronësisë në bazë të parashkrimit fitues.

Kohëzgjatja e trajnimit: një ditë

Përfituesit: Avokatët

1.3. PASURIA E PËRBASHKËT E BASHKËSHORTËVE DHE BASHKËSIVE FAMILJARE DHE PJESTIMI I SAJ

HYRJE

Bashkëpronësia dhe pronësia e përbashkët paraqesin një prej formave të pronësisë kur shumë subjekte kanë autorizime pronësore mbi një send.

Ekzistojnë dallimet në mes të këtyre dy formave të pronësisë sa i përket përcaktimit të pjesëve ideale. Në praktikë paraqiten dilema në dallimin e këtyre dy formave të pronësisë, prandaj

Qëllimi i këtij trajnimi do të fokusohet në zgjidhjen e dilemave, paqartësive që paraqiten në interpretimin dhe implementimin në procesin e vendimarrjes. Synimi kryesor i këtij trajnimi konsiston në faktin që, duke shqyrtuar praktikën relevante gjyqësore të qëndrueshme të ndërtohen standardet e njëjta juridike, me intencë që të arrihet siguria juridike e palëve dhe rrjedhimisht stabiliteti social. Veçmas duhet të ipen sqarime lidhur me shkrirjen e kontributit të bashkëshortëve në pronësi të përbashkët të bashkësisë familjare, si dhe vërtetimit të kontributit të njërit bashkëshort në krijimin e pronësisë së përbashkët të bashkësisë familjare.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij sesioni pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të dallojnë këto forma të drejtave të pronësisë dhe të vendosin në raste kontesti në mes të subjekteve për këto forma të pronësisë;
- Të përkufizojnë të drejtat e pronarëve të përbashkët e veçmas të drejtën e pjesëtimit të pronësisë së përbashkët dhe mënyra e pjesëtimit;
- Të zbatojnë dispozitat ligjore në mënyrë të drejtë në rastet e vërtetimit të kontributit të bashkëshortëve të pronësia e përbashkët e bashkëshortore;
- Si vërtetohet kontributi i anëtarëve të bashkësisë familjare në pronësinë e përbashkët të bashkësisë familjare.

Kohëzgjatja e trajnimit: një ditë

Përfituesit: Avokatët

1.4. PARASHKRIMI I KËRKESAVE SIPAS LMD-SË

HYRJE

Parashkrimi është institut juridik i së drejtës detyrimore sipas të cilit kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore, pra nga aparati i dhunës-gjykatës si organ shtetëror, për shkak të kalimit të kohës brenda të cilës është dashur të parashtrohet padia. Parashkrimi i kërkesave ndodh me qëllim të garantimit të sigurisë juridike, që kreditorët kërkesat e tyre ti mbrojnë në afat të caktuar sepse mund të ndodh që të bëhet e pa mundur mbrojtja e të drejtave përmes rrugës gjyqësore, për shkak të kalimit të kohës së përcaktuar me ligj.

Parashkrimi, mund të thuhet se konsiderohet njëri ndër institutet më të rëndësishme të së drejtës detyrimore, sepse ai siguron marrëdhëniet juridike detyrimore të jenë më të qëndrueshme. Kreditorët duhet të janë shumë të kujdesshëm që kërkesat e tyre të realizohen dhe të mos lejohet që parashkrimi të ketë ndikim në marrëdhëniet e tyre detyrimore. Andaj, parashkrimi paraqet një nga mënyrat e shuarjes së detyrimit deri te i cili vjen me sjellje pasive të kreditorit dhe sjellje aktive të debitorit.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- zgjerojnë njohuritë mbi parashkrimin;
- llogarisin afatet e parashkrimit;
- të përcaktojnë kohën e rrjedhjes së parashkrimit;
- të dallojnë ndërprerjen dhe ndaljen e parashkrimit.

Kohëzgjatja e trajnimit: një ditë

Përfituesit: Avokatët

Trajnues:

1.5. PAVLEFSHËMRIA E KONTRATAVE

HYRJE

Kontrata është burimi kryesor dhe më i rëndësishëm i marrëdhënieve të detyrimeve. Kontrata është marrëveshje e dy apo më shumë personave, që ka për qëllim të krijojë, ndryshojë ose të shuaj një marrëdhënie juridike të detyrimit. Ligji mbi detyrimet konstaton se “kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë pajtuar për elementet thelbësore. Fusha e zbatimit të kontratës është e gjerë. Kontrata zbatohet gati në të gjitha degët e së drejtës, përveç në të drejtën penale.

Kontrata e lidhur nga palët kontraktuese krijojnë efekte juridike, e pastaj shuhen. Shuarje e kontratës konsiderohet shuarja e kontratës së plotfuqishme me vullnetin e palëve kontraktuese për shkaqe të parapara me ligj.

Nocioni "Pavlefshmërisë së kontratës" përfshin format konkrete të pavlefshmërisë së kontratës siç janë: nuliteti dhe rrëzueshmëria. Ligji mbi marrëdhëniet e detyrimeve (LMD), kur parasheh sanksionin për pavlefshmërinë e kontratës, nuk flet për pavlefshmërinë, por konkretisht parasheh nulitetin dhe rrëzueshmërinë.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të :

- Kuptojnë shuarjen e kontratave;
- Dallojnë kushtet ligjore të cilat duhet të plotësohen për tu konsideruar një kontratë nule dhe e rrëzueshme
- Njohin dhe identifikojnë pasojat e nulitetit absolut dhe relativ të kontratave

Kohëzgjatja e trajnimit: një ditë

Përfituesit: Avokatët

1.6. SHPRONËSIMI DHE PROCEDURA E SHPRONËSIMIT SI DHE KOMPENSIMI

HYRJE

Siç dihet instituti juridik i eksproprijimit, e që tani quhet shpronësim, deri në vitin 2009, ka qenë juridikisht i rregulluar me Ligjin për eksproprijimin (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr. 21/1978) me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e saj, ndërsa pas shpalljes së pavarësisë, Republika e Kosovës nxori Ligj tjetër me të cilin ka rregulluar juridikisht këtë institut juridik i cili tani është emërtuar si Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme i shpallur në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 52, datë 8 maj 2009. Pronari mund të zhvishet nga e drejta e pronësisë vetëm nën kushtet e parapara me ligj me kusht që shpronësimi të bëhet për qëllim të interesit të përgjithshëm.

Prandaj do të jenë pjesë e trajnimit këto tema:

- 1.6.1. Organi kompetent për shpronësim,
- 1.6.2. Procedura e cila duhet paraprirë shpronësimi,
- 1.6.3. Procedura e vlerësimit të pasurisë e cila është objekt i shpronësimi dhe caktimi i kompensimit,

1.6.4. Raste nga praktika.

OBJEKTIVAT

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- analizojnë procedurat e shpronësimit,
- analizojnë dhe identifikojnë kushtet paraprake për shpronësim,
- dallojnë rastet kur organ shpronësues mund të jetë komuna e kur organ shpronësues mund të paraqitet qeveria dhe
- njohin mënyrën e inicimit dhe përfundimit të procedurës së shpronësimit.
- kuptojnë procedurën caktimit të kompensimit,
- vlerësojnë se çka përfshinë kompensimi,
- raste nga praktika.

Kohëzgjatja: Një ditore

Përfituesit: Avokatët

1.7. SHPËRBLIMI I DËMIT MATERIAL DHE JO MATERIAL

HYRJE

Numri i madh i kontesteve gjyqësore për shpërblimin e dëmit, qoftë të dëmit material apo jo material, praktika gjyqësore jo e harmonizuar sa i përket vendosjes dhe kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit jo material, janë indikator që tregojnë se kjo temë është shumë me rëndësi të trajtohet me avokatë.

TEMAT që do të përmbaj ky trajnim janë:

- 1.7.1. Format e dëmit material dhe jo material,
- 1.7.2. Lartësia e kërkesës për dëm,
- 1.7.3. Marrëveshjet jashtëgjyqësore për shpërblimin e dëmit,
- 1.7.4. Lartësia e kamatës dhe llogaritja e saj,
- 1.7.5. Raste nga praktika.

OBJEKTIVAT

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- dallojnë format e dëmit,
- kuptojnë kriteret për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit,
- llogarisin kamatën për dëmin jo material.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

1.8. VËRTETIMI DHE KUNDËRSHTIMI I ATËSISË OSE AMËSISË

HYRJE

Është temë e ndjeshme meqenëse përfaqëson një rëndësi të drejtat themelore në raportin prindër - fëmijë dhe anasjelltas. Në gjykatat e Kosovës mbetën pa u zgjidhur shumica e lëndëve të kësaj natyre, për shkak të mungesës të institucioneve që bëjnë ekspertiza lidhur me analizat e nën grupeve të gjakut si dhe ADN-së. Me qëllim që avokatët të jenë sa më të suksesshëm në këto konteste është e nevojshme të marrin informata lidhur me çështje procedurale në këto konteste dhe llojet e ekspertizës që duhet të kryhen për çfarë temë e shqyrtimit do të jenë:

- Procedura gjyqësore në kontestet rreth vërtetimit dhe kundërshtimit të atësisë ose amësisë,
- Kundërshtimi i atësisë ose amësisë nga personi i tretë,
- Administrimi i provave me rastin e vërtetimit si dhe mohimit të atësisë ose amësisë,
- Raste nga praktika.

OBJEKTIVAT

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- identifikojnë afatet ligjore për ushtrimin e padisë për vërtetim ose mohim të atësisë dhe amësisë,
- kuptojnë se cilat prova duhet propozuar për tu administruar,

- raste nga praktika.

Kohëzgjatja e trajnimit: Njëditor

Përfituesit: Avokatët

1.9. PJESA E DOMOSDOSHME E TRASHËGIMISË

HYRJE

E drejta e disponimit është e drejtë e çdo personi dhe ajo në shumicën e rasteve nuk paraqet kufizime. Personi mund të disponoj me pasurinë e tij gjatë jetës si edhe në rast vdekjes. Disponimi i pasurisë është i kufizuar me pjesën e domosdoshme. Pjesa e domosdoshme e trashëgimisë i takon vetëm trashëgimtarëve të domosdoshëm të trashëgimisë në pjesën që u takon sipas ligjit.

Temë e shqyrtimit në këtë trajnim do të jetë:

- 1.9.1. pjesa e domosdoshme e trashëgimisë,
- 1.9.2. trashëgimtarët e domosdoshëm,
- 1.9.3. llogaritja e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë,

OBJEKTIVAT

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- identifikojnë se cilët janë trashëgimtarët e domosdoshëm,
- kuptojnë llogaritjen e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë,
- përcaktojnë pjesën e domosdoshme të trashëgimisë të trashëgimtarëve të rendit të parë dhe rendit të dytë,
- Raste nga praktika.

Kohëzgjatja e trajnimit: Njëditor

Përfituesit: Avokatët

1.10. SIGURIMI I KËRKESËPADISË

HYRJE:

Për shkak se procedura për nxjerrjen e vendimit në një çështje juridiko kontestuese mund të zgjatet ashtu që paditësi i cili ka inicuar procedurën nuk mund të realizoj kërkesën e tij gjerë në marrjen e vendimit të formës së prerë nga ana e gjykatës. Ligji i jep mundësi që për hirë të sigurisë së paditësit që në çdo fazë të procedurës e në kushtet e përcaktuara me ligj të propozoj masat e sigurimit të kërkesëpadisë me të cilat sigurohet paditësi në realizimin e kërkesës së tij. Për aprovimin e masave të sigurisë të propozuara nga ana e paditësit duhet të plotësohen kushtet ligjore.

Prandaj temë e shqyrtimit në këtë trajnim do të jetë:

- 1.10.1. kuptimi i masave të sigurimit të kërkesëpadisë;
- 1.10.2. llojet e masave për sigurimin e kërkesëpadisë;
- 1.10.3. kushtet për lejimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë;
- 1.10.4. garancioni.

OBJEKTIVAT

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- të kuptojnë masat e sigurimit të kërkesëpadisë,
- të dallojnë masën e sigurimit të kërkesëpadisë dhe masën e përkohshme,
- të njohin procedurat dhe kushtet për lejimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë,
- të kuptojnë rëndësinë dhe kushtet e garancionit.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët.

1.11. NDRYSHIMI I PADISË

HYRJE

Gjatë zhvillimit të procedurës kërkohet e nevojshme në disa raste të bëhet ndryshimi i padisë, e që nënkupton ndryshimin e njësisë së kërkesëpadisë, zmadhimi i kërkesëpadisë, apo parashtrimi edhe i një kërkesë tjetër krahas asaj ekzistuese. Duhet pas parasysh se padia nuk

quhet e ndryshuar, po që se paditësi e ka ndryshuar bazën juridike të kërkesëpadiës, po që se e ka zvogluar kërkesëpadinë, apo po që se i ka ndryshuar, plotësuar apo përmirësuar thëniet e cekura në padi.

OBJEKTIVAT

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- kuptojnë se çfarë përfaqëson ndryshimi i padisë;
- kur mund të bëhet ndryshimi i padisë;
- në cilën fazë të procedurës kërkohet pëlqimi i të paditurit;
- të dallojnë ndryshimin objektiv dhe subjektiv të kërkesëpadiës.

Kohëzgjatja e trajnimit: Një ditë

Përfituesit: Avokatët.

1.12. MJETET E RREGULLTA DHE MJETET E JASHTËZAKONSHME JURIDIKE TË GODITJES SË VENDIMEVE

HYRJE

Në këtë modul do të bëhet fjalë për ankesën kundër aktgjykimit si mjet të rregullt juridik, procedurën rreth ankesës dhe vendimet të cilat merren nga ana e gjykatës instancionale më të lartë si dhe për mjetet e jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve gjyqësore.

Prandaj temë e shqyrtimit në këtë trajnim do të jetë:

1.12.1. Veprimi i gjykatës së shkallës së parë sipas mjeteve të goditjes së vendimeve gjyqësore,

1.12.2. Veprimi i gjykatës së shkallës së dytë sipas mjeteve të rregullta juridike,

1.12.3. Veprimi i gjykatës së shkallës së parë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike,

1.12.4. Veprimi i gjykatës së revizionit sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij prezantimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Të bëjnë vlerësimin e aktgjykimit dhe mundësisë së ankesës kundër tij,

- Të përpilojnë ankesë kundër aktgjykimit,
- Të përpilojnë ankesë kundër aktvendimit,
- Të dinë se në çfarë afati mund ta kryejnë këtë veprim procedural,
- Të dinë përmbajtjen e ankesës dhe shkaqet për shkak të të cilave mund të ushtrohet një ankesë,
- Të dallojnë shkeljet thelbësore të procedurës kontestimore nga gjendja faktike dhe aplikimi i gabuar i të drejtës materiale,
- Të njohin procedurën sipas mjeteve të zakonshme dhe
- Të dinë vendimet e gjykatës instancionale më të lartë.
- Të vlerësojnë drejtë mundësinë e ushtrimit të mjetit të jashtëzakonshëm,
- Të përpilojnë revizionin kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë;
- Të përpilojnë revizionin kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë;
- Të dinë se në çfarë afati mund ti kryejnë këto veprime procedurale,
- Të dinë të ushtrojnë kërkesën për përsëritjen e procedurës dhe
- Të përpiloj propozimin për ushtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

1.13. DISKRIMINIMI DHE MEKANIZMAT LIGJOR PËR PARANDALIMIN E TIJ HYRJE

Konventa e Europiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) në nenin 14, repektivisht në Protokollin e 12, mbronë nga diskriminimi çfarëdo të drejte I parashikuar me ligj dhe nga cdo autoritet public, duke ofruar kështu fushveprim më të gjerë se sa në nenin 14, që ndërlidhet vetëm me të drejtën e garantuar nga KEDNJ.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ka bërë pjesë të pandashme të rendit juridik të vendit instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njerit ndër të cilat është edhe KEDNJ.

Më tej, mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë dhe kaluzolat e mosdiskriminimit, përfshihen edhe në ligje të shumta të Kosovës, veçanarishtë në Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi. Ka raste kur ligjet tjera i referohen Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, ndërsa ka të tjerë që

numërojnë bazat e mbrojtura të cilat shpesh ndryshojnë nga bazat e mbrojtura të përfshira në Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi. Për më tepër, Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ofron veçoritë procedural në trajtimin e lëndëve të diskriminimit që gjithësesi prekin procedurat e parapara me ligjet tjera, në veçanti Ligjin për procedurën kontestimore dhe Ligjin e Punës.

Objektiva e trajnimit:

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

- Interpretojnë drejtë dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me diskriminimin
- Njohin kompleksitetet praktike në situatat kur ndërverprojnë ligjet në rastet e diskriminimit
- Analizojnë trajtimin e rasteve të diskriminimit në procedurën kontestimore, përfshirë këtë në trajtimin e kontesteve të punës me elemente diskriminimi; si dhe
- përafrojnë qëndrimet në zbatimin unik të dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me diskriminimin.

Kohëzgjatja: Një ditë

Përfituesit: Avokatët

1.14. MBROJTJA NGA DHUNA NË FAMILJE

HYRJE

Dhuna në familje, paraqet një fenomen negativ të përhapur që sfidon jo vetëm shoqërinë kosovare në përgjithësi por edhe sistemin e drejtësisë në veçanti. Korniza ligjore dhe ajo institucionale në këtë fushë është kryesisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare dhe si akt i brendshëm juridik me të cilin rregullohet kjo fushë, si dhe mekanizmat për mbrojtje kundër dhunës në familje, rregullohen me Ligjin për mbrojtje nga Dhuna në Familje. Gjithashtu si akt me rëndësi në këtë fushë është Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit), e cila është pjesë e legjislacionit të Kosovës sipas amandamentit kushtetues.

OBJEKTIVAT e modulit të trajnimit:

Pas përfundimit të këtij trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Avancojnë njohuritë lidhur me legjislacionin për këtë fushë;
- Zgjerojnë njohuritë me praktikën unike në zbatim të legjislacionit;
- Analizojnë dispozitat të cilat i referohen rasteve të shkeljes së urdhrit mbrojtës;

Shkelja e urdhrit mbrojtës dhe dhe pasojat juridike të shkeljes.

Kohëzgjatja: Një ditore

Përfituesit: Avokatët

1.15. MBROJTJA GJYQËSORE NË KONTESTET NGA MARRËDHËNIA E PUNËS HYRJE

Numri i madh i kontesteve nga marrëdhënia e punës është paraqitur si pasojë e mangësisë në legjislacionin në fuqi, ku mbrojtja gjyqësore nuk ka qenë adekuate, e për këtë arsye punëtorit i janë cënuar të drejtat nga marrëdhënia e punës. Si rezultat i kësaj, në praktikën gjyqësore ka pasur vështirësi në zbatimin adekuat dhe dhënien adekuate të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve nga marrëdhënia e punës.

Ky trajnim është dizajnuar dhe strukturuar në mënyrë që të analizoj dhe zbërthej procedurën e filluar për mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës, duke identifikuar kushtet paraprake nga kërkuesi para se ti drejtohet gjykatës me padi.

OBJEKTIVAT

Objektivi i këtij trajnimi është që pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi të jenë në gjendje të:

- Dallojnë kontestet për shërbyesit civil dhe kontestet tjera nga marrëdhënia e punës sipas ligjit të punës;
- Të vlerësojnë paraprakisht kushtet për të ofruar mbrojtje efikase në këto konteste dhe të vlerësojnë afatet për të kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Kohëzgjatja: Një ditore

Përfituesit: Avokatët

3.TRAJNIMET NGA FUSHA ADIMINISTRATIVE, E PUNËS, EKONOMIKE DHE KUNDERVATJTËSE

3.1. INICIMI DHE ZHVILLIMI I KONFLIKTIT ADMINISTRATIV

Në kuadër të këtij trajnimi që për fokus ka procedurën e konfliktit administrativ do të trajtohen edhe TEMAT që lidhen me mbrojtjen gjyqësore dhe adresimin e ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe rrjedhimisht Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit. Në procedimin e këtyre rasteve në praktikë po paraqiten dilema të ndryshme profesionale, procedurale dhe materiale përkitazi me procedimin e këtyre lëndëve. Me këtë trajnim synohet ofrimi i zgjidhjeve praktike të bazuara në ligj të cilat do të lehtësonin punën e avokatëve në iniciimin e konfliktit administrativ dhe përfaqësimin e palës në gjykatën kompetente.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Interpretojnë drejtë dispozitat ligjore për procedurën e konfliktit administrativ;
- Kuptojnë rolin dhe rëndësin e nxjerrjes së provave gjatë shqyrtimit kryesor;
- Të zbatojnë drejtë dispozitat ligjore me rastin e parashtrimit të mjeteve juridike;

Përmbajtja

- Hartimi i padisë për iniciimin e konfliktit administrativ;
- Rëndësia e dispozitave ligjore për procedurën e konflikteve administrative;
- Procedura ligjore, roli dhe rëndësia e nxjerrjes së provave gjatë shqyrtimit kryesor;
- Përmbartimi i vendimeve të nxjerrura në këtë procedurë.

Metodologjia

Dilemat dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes diskutimit interaktiv, përdorimit të raste praktike si dhe puna në grupe.

Përfituesit: Avokatët

Kohëzgjatja: Një ditore

1.2. Procedurat e prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, me theks të veçantë kontestet me OSHP-në

HYRJE

Çështjet që do të trajtohen në këtë trajnim kanë të bëjnë me procedurat e prokurimit, zbatimin fillestar të procedurës së shqyrtimit, vlerësimin e shkresave nga eksperti shqyrtues dhe rekomandimin për OSHP. Do të analizohen dispozitat ligjore që përmban Ligji për Prokurimin Publik duke zbërthyer kriteret lidhur me ciklin e procesit të prokurimit publik dhe kontestet me OSHP-në. Meqenëse në praktikë shpeshherë ka probleme rreth këtyre kriterëve dhe në vlerësimin e tyre konform peshës së tyre si dhe dilema ligjore, shtrohet nevoja e trajtimit të tyre. Me interes është edhe trajtimi i procedurave në Organin për Shqyrtimin e Prokurimit Publik dhe mënyrën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Në këtë trajnim çështjet që do të trajtohen do të jenë udhëheqja e procedurave të prokurimit, fillimi dhe zbatimi i procedurës së shqyrtimit, trajtimi fillestar i shkresave nga eksperti shqyrtues dhe rekomandimi për OSHP. Në procedurën e prokurimit publik nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do t'i jepet operatorit ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate a do të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me Ligjin e prokurimit publik.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbërthejnë etapat e procedurës së prokurimit publik;
- Identifikojnë karakteristikat e padisë në procedurën e konfliktit administrativ sipas Ligjit për Prokurimin Publik;
- Interpretojnë drejtë dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Përmbajtja

- Hartimi i padive për inicimin e konfliktit administrativ për çështjet që ndëlidhen me OSHP;

- Udhëheqja e procedurave të prokurimit – dispozitat e përgjithshme;
- Fillimi dhe zbatimi fillestar i procedurës së shqyrtimit;
- Hartimi i mjeteve juridike në këtë procedurë.

Metodologjia

Metodat kryesore që do të përdoren gjatë trajnimit janë: ligjërime të përgjithshme, diskutime interaktive dhe analizë kritike të dispozitave ligjore dhe rasteve nga praktika. Materiali teorik është strukturuar në mënyrë që koha më e madhe t'iu lihet debateve dhe diskutimeve me pjesëmarrësit.

Përfitues: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditë

1.3. Zbatimi i Ligjit për Zyrtarët Publik

HYRJE

Ndër qëllimet kryesore të këtij trajnimi është sqarimi i dispozitave ligjore lidhur me pozitën e zyrtarëve publik, ngase ky ligj përmban bazën ligjore për punësim të zyrtarëve publikë në institucionet e Republikës së Kosovës, të bazuar në merita, integritet moral, paanësi dhe qëndrueshmëri. Me këtë ligj bëhet edhe klasifikimi i vendeve të punës në administratën publike që nënkupton çdo kategori funksionale të zyrtarëve publik, duke përfshirë gradat e punës, të cilat përcaktohen në bazë të përgjegjësisë. Aktualisht pas hyrjes në fuqi të këtij ligji janë dhe do të paraqiten dilema dhe vështirësi në zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me pozitën e zyrtarëve publik, mënyrën e punësimit të tyre, lidhur me të drejtat dhe detyrimet të cilat i përcakton Ligji për zyrtarët publikë, siç është e drejta për trajtim të barabartë, e drejta për pagë, e drejta në vendin e punës, ruajtjen e pozitës ekuivalente, si dhe mbrojtjen gjyqësore në këto konteste.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zbërthejnë procedurat para organit administrativ me rastin e nxjerrjes së akt-emërimit për zyrtarët publik;
- Bëjnë dallimet në mes të kategorive të ndryshme të zyrtarëve publik;

- Njohin të drejtat e zyrtarëve publik;
- Zbatojnë drejtë dispozitat e Ligjit për zyrtarët publik.

Përmbajtja:

- Procedurat para organit administrativ me rastin e punësimit për zyrtarët publik;
- Klasifikimi i zyrtarëve dhe të drejtat e zyrtarëve publik;
- Masat disiplinore dhe menaxhimi i kontesteve.
- Inicimi dhe përfaqësimi në gjykatë i këtyre kontesteve.

Metodologjia

Dilemat dhe çështjet e ngritura gjatë trajnimit do të adresohen përmes shpjegimit të pjesshëm teorik, rasteve dhe shembuj konkret nga praktika gjyqësore.

Përfituesit

Avokatët.

1.4. Procedura kundërvajtëse sipas kërkesës së inspektoreve

HYRJE

Gjatë punës së tyre, avokatët hasin në shumë paqartësi lidhur me kërkesat për zhvillimin e procedurës së kundërvajtjes të paraqitura nga inspektoratet e lëmive të ndryshme. Në raste të shumta kërkesat e inspektorateve paraqiten ndaj personave juridik dhe jo edhe ndaj personit përgjegjës të personit juridik, paraqiten ndaj subjektit afarist përgjegjësia e të cilit është individuale, por në kërkesë akuzohet edhe pronari i subjektit afarist. Gjithashtu problem permanent i këtyre kërkesave është edhe cilësimi juridik i veprimeve kundërvajtëse dhe dispozitat sanksionuese, sepse aplikohen dispozita ligjore të parapara në disa ligje, ose plotësim-ndryshim të ligjeve.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Të avancojnë njohuritë lidhur me procedurën e kundërvajtjes të inicuar me kërkesë të inspektorëve përkatës;
- Të përpilojnë mjetet juridike përkatëse, me të cilat atakohen vendimet e gjykatës;
- Të kuptojnë drejtë procedurat në rastet kur kërkesa nuk është e përpiluar konform ligjit;

Përmbajtja e trajnimit

- Përmbajtja e kërkesës e paraqitur nga organet kompetente-inspektoret;
- Përshkrimi faktik i veprimeve nga të cilat rezultojnë tiparet juridike të kundërvajtjes;
- Vendimi për fillim të procedurës- kushtet.
- Mjetet juridike përkatëse, me të cilat atakohen vendimet e gjykatës.

Metodologjia e trajnimit

Për realizimin e këtij trajnimi do të përdoren metodat e kombinuara: shpjegimi i shkurtë teorik, diskutimet interaktive, prezantime në PowerPoint, pyetje e përgjigje, të përcjellura me shembuj praktik, dhe analizimi i përbashkët i problemeve rrethe aplikimit të këtyre dispozitave në praktikë, në mënyrë që secili nga pjesëmarrësit të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit.

Përfituesit: Avokatët.

Kohëzgjatja një ditorë

1.5. Falimentimi

HYRJE

Procedura e falimentimit synon të shlyejë në mënyrë kolektive detyrimet e debitorit përmes riorganizimit të aktivitetit ose përmes likuidimit të të gjitha pasurive të debitorit dhe shpërndarjes të të ardhurave. Ky ligj rregullon procedurat e likuidimit dhe riorganizimit të të gjitha shoqërive tregtare, duke përfshirë edhe Bizneset individuale, Ortakëritë e përgjithshme dhe Ortakëritë e kufizuara, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose Shoqëri aksionare. Trajtimi i kësaj teme synon të ngritë ekspertizën profesionale të avokatëve në këtë fushë, të krijohet praktikë dhe ekspertizë profesionale në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe përvojat dhe praktikat me të mira të shteteve në rajon dhe të zbatohen instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë. Trajnimi është dizajnuar në atë formë që të adresoj dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktiken gjyqësore aktuale, përmes diskutimeve të pjesshme teorike, diskutimeve interaktive mes pjesëmarrësve dhe prezantimit të rasteve praktike.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Vlerësojnë drejtë specifikat e hapjes së rastit të falimentimit, procedurat ligjore, afatet dhe vendimet e gjykatës;
- Njohin kërkesat e kreditorëve, mënyra e paraqitjes, afatet dhe prioriteti i kërkesave;
- Zgjerojnë njohuritë lidhur me riorganizimin, likuidimin dhe specifikat e tyre;

Përmbajtja

- Procedurat e përshpejtuara (NVM dhe para-pakot);
- Kërkesat e kreditorëve;
- Riorganizimi dhe Likuidimi;
- Lirimi individual dhe Mbyllja e rastit;
- Dispozitat ndërkufitare.

Metodologjia

Ky trajnim do të aplikojë një metodologji interaktive, diskutime, punë në grupe si dhe shqyrtimi i rasteve nga praktika gjyqësore.

Përfituesit: Avokatët.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.6. Arbitrazhi

HYRJE

Arbitrazhi si metodë alternative e zgjidhjes së kontesteve konsiderohet si një nga rrugët drejt zgjidhjes më të shpejt dhe efikase të kontesteve të natyrës ekonomike. Suksesi i arbitrazhit varet drejtpërdrejtë nga njohja dhe zbatueshmëria e këtyre vendimeve, duke marrë parasysh se vendimet e arbitrazhit janë titull ekzekutiv vetëm pasi të jenë njohur nga gjykata kompetente në Kosovë. Në këtë kontekst, është e domosdoshme që avokatët të kenë njohuri të avancuara sa i përket procedurës së njohjes së vendimeve të arbitrazhit dhe specifikave të tjera. Trajnimi do të fokusohet në ngritjen e ekspertizës profesionale të avokatëve në këtë fushë, përmes së cilës do të mund të krijohet praktikë gjyqësore në përputhje me standardet

ndërkombëtare, si dhe përvojat dhe praktikat me te mira të shteteve në rajon dhe të zbatohen instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Zgjerojnë njohuritë rreth kompetencave të gjykatës në procedurën e arbitrazhit;
- Avancojnë njohuritë për procedurën e marrëveshjes së arbitrazhit;
- Njohin të drejtat dhe detyrimet e palëve;
- Interpretojnë drejtë Konventën e New York për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit.

Përmbajtja

- Inicimi i procedurës së arbitrazhit dhe kompetencat e gjykatës;
- Kontestet që mund të jenë objekt i arbitrazhit;
- Klauzola e marrëveshjes së arbitrazhit;
- Procedura e arbitrazhit, të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurë;
- Ligji Kosovar për njohjen e vendimeve të arbitrazhit;
- Inicimi i procedurës së njohjes;
- Praktikrat e njohjes së vendimeve të arbitrazhit;
- Procedurat e parapara në Konventën e New York për zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit;
- Njohja dhe zbatimi i vendimeve të huaja të arbitrazhit në Kosovë;
- Mjetet juridike të aplikueshme.

Metodologjia

Metodologjia e trajnimit përfshinë prezantime të cilat orientohen dhe përdorin si shembuj raste konkrete dhe hipotetike. Kjo metodologji bazohet në ushtrime, diskutime, simulime, dhe aktivitete të përpiluara për aplikimin e koncepteve të strukturave afariste në situata praktike.

Përfituesit: Avokatët.

Kohëzgjatja: Një ditorë.

1.7. Mospërbushja e kontratave në kontestet tregtare

HYRJE

Në ekonominë e tregut bizneset e zhvilluara të cilat merren me veprimtari specifike, përdorin kontrata që janë specifike për afarizmin e tyre, e të cilat dallojnë si për nga struktura ashtu edhe nga të drejtat dhe detyrimet që krijojnë për palët. Këto kontrata kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të veçantë me rastin e zbatimit dhe interpretimit të dispozitave kontraktuese andaj kërkohen njohuri të posaçme, jo vetëm juridike por edhe nga fushat që mbulojnë këto kontrata. Prandaj, për shkak të kompleksitetit shpesh këto kontrata nuk arrijnë të zbatohen në tërësi dhe lindin konteste ndërmjet palëve kontraktuese, zgjidhje e të cilave është mjaft komplekse. Trajnimi do të synon në ngritjen e ekspertizës profesionale të avokatëve në këtë fushë, të identifikohet praktika gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe përvojat dhe praktikat me të mira të shteteve në rajon dhe të zbatohen instrumentet ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që të:

- Njohin specifikat e kontratave në sferën ekonomike;
- Avancojnë njohurit lidhur me pengesat në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale;
- Zgjerojnë njohurit rreth shkaqeve të pavlefshmërisë së kontratës dhe pasojave e mos zbatimit të kontratës.

Përmbajtja

- Specifikat e kontratave në fushën ekonomike;
- Pengesat në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale;
- Rrëzueshmëria e kontratës dhe nuliteti i saj;
- Mospërbushja e detyrimit - vonesa;
- Pasojat juridike të vonesave në përmbushjen e detyrimit dhe shkëputja e kontratës;

- Procedurat ligjore në mbrojtjen e të drejtave të palëve afariste, në kontestet që rrjedhin nga mos përmbushja e këtyre kontratave;
- Mënyrat dhe kriteret e vlerësimit të elementeve specifike në rastet të pretendimeve për mos përmbushje apo kontestimin e vlefshmërisë së këtyre kontratave.

Metodologjia

Në këtë trajnim do të aplikohet metodologji interaktive, prezantim i rasteve hipotetike dhe rasteve konkrete nga praktika gjyqësore.

Përfituesit: Avokatët.

Kohëzgjatja: Një ditore

1.8. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe efektet juridike të tyre

HYRJE

Qëllimi i organizimit të këtij trajnimi është thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me rolin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe vendimeve të saj, natyrën juridike, efektin si dhe mënyrën e përmbartimit të tyre. Në praktikën e Gjykatës Kushtetuese dallohen disa lloj vendimesh në varësi nga qëndrimi që ato mbajnë ndaj normave që kontrollojnë. Po kështu, edhe proceset që kryhen nëpërmjet vendimeve mund të kenë natyra të ndryshme. Roli i Gjykatës Kushtetuese qëndron pikërisht në fuqinë e vendimeve të saj. Mirëpo realizimi dhe zbatimi praktik i vendimeve gjyqësore kushtetuese është një çështje me rëndësi të veçante që kërkon trajtim të gjithanshëm.

OBJEKTIVAT

Pjesëmarrësit pas përfundimit të këtij trajnimi do të jenë në gjendje që:

- Të njohin rolin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe të zbërthejnë efektet juridike të cilat prodhojnë vendimet e Gjykatës Kushtetuese,
- Të vlerësojnë drejtë natyrën juridike dhe detyrueshmërinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës,

Përmbajtja:

- Inicimi i procedurës dhe përfaqësimi i palës ankuese në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës
- Roli i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe vendimeve të saj.
- Llojet dhe natyra juridike e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe efektet e tyre,
- Përmbartimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Metodologjia

Ndër metodat kryesore që do të përdoren gjatë këtij trajnimi do të jenë: shpjegime të pjesshme teorike dhe raste nga praktika gjyqësore, diskutime interaktive në grupe të ndara dhe analizë të rasteve gjyqësore nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës.

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditore

4. TRAJNIMET NGA FUSHA E KODIT TË ETIKËS PROFESIONALE

4.2.KRIJIMI I BESIMIT NË PUBLIK-PARAQITJA E AVOKATËVE NË MEDIA

HYRJE

Ky modul ka rëndësi të veçantë për avokatët , sepse paraqitja e avokatit në publik tregon integritetin e tij personal dhe profesional por edhe të organizatës që ai e përfaqëson. Nga avokatët pritet të kenë një përfaqësim dinjitoz që dhe të kujdesshëm për çështjet që i paraqet.

Të ruaj privatësinë e klientit dhe familjes së tij;

Të mos deklarohet pa autorizimin e klientit;

Të ruaj profesionin e avokatisë dhe OAK-së.

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditore

4.3. FSHEHTËSIA PROFESIONALE

Ky modul ka për qëllim që të ruaj interesin dhe privatësin e klientit në realizimin e qëllimit të tij , njëherit me ruajtjen e fshehtësis profesionale arrihet qëllimi i integritetit profesional të avokatit.

OBJEKTIVAT

Pas përfundimit të këtij trajnimi, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje që:

Të kuptojnë përmbajtjen e Kodit të Etikës profesionale, rregullores për procedurën Disiplinore;

Të zbatojnë në praktikë ndryshimet e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullores për procedurën Disiplinore;

Të zbatojnë drejtë tarifën e OAK-së

Të kuptojnë drejtë mënyrën e përpilimit të listës së shpenzimeve

Të kuptojnë rëndësinë e Sistemit Disiplinor në OAK, bazuar në Rregulloren për procedurën disiplinore;

Të identifikojnë ndryshimet në kodin e etikës, rregulloren për proc. Disiplinore,

Tarifën e OAK-së.

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditorë

4.4. KONFLIKTI I INTERESIT

HYRJE

Ky modul ka për qëllim shmangien e konfliktit të interesit , në mes të avokatit dhe palëve në procedurë që ndërlidhet me përfaqësimin apo mbrojtjen e drejtë përdrejtë e cila bëhet në gjykatë apo pranë organeve tjera. Në praktikë avokatët nuk kujdesen me respektimin e këtij parimi andaj është e domosdoshme për të ju shmangur situatave të këtilla që të përfitojnë njohuri të sakta lidhur me këtë modul.

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditorë

4.5. RAPORTI ME KLIENTIN, PALËN KUNDËRSHTARE

Hyrje

Ky modul ka për qëllim që të sqaroj dhe informoj avokatët se cili duhet të jetë raporti me klientin mbi cilat baza duhet ta krijoj këtë raport me klientin si dhe të përcaktojë sjelljet në raport me palën kundërshtare.

OBJEKTIVAT

Që avokati të ketë të qartë se si krijohet raporti profesional me klientin.

Që avokati të ketë të qartë si duhet të jetë sjellja me palën kundërshtare .

Të kuptojnë përmbajtjen e Kodit të Etikës profesionale, Rregullores për procedurën Disiplinore;

Të zbatojnë në praktikë ndryshimet e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullores për procedurën Disiplinore;

Të zbatojnë drejtë tarifën e OAK-së

Të kuptojnë drejtë mënyrën e përpilimit të listës së shpenzimeve

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditorë

4.6. RAPORTI ME ODËN DHE OBLIGIMET NDAJ ODËS SË AVOKATËVE

HYRJE

Ky modul është i nevojshëm me qëllim që avokatët të kuptojnë që raporti me OAK në vetëvete ka raporte të ndërsjellta të të drejtave dhe obligimeve. Për faktin se avokatët në RKS janë avokat aktiv dhe ushtrimi i profesionit të tyre është i lidhur me licencimin nga OAK, atëherë obligimet që avokatët i kanë ndaj OAK-së duhet të kuptohen janë raporte me obligim reciproke.

OBJEKTIVAT

Që avokatët të njoftohen më hollësisht me të drejtat dhe detyrimet .

Që avokatët të kuptojnë cilat janë obligimet e tyre ndaj OAK-së

Që Avokatët të kuptojnë cilat janë benifitet nga OAK

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditorë

4.7. KOMUNIKIMI ME GJYKATËN , PROKURORINË DHE INSTITUCIONET

SHTETËRORE

HYRJE

Ky modul është i nevojshëm me qëllim që avokatët ta avancojnë komunikimin me institucionet në nivelin etik dhe profesional .

OBJEKTIVAT:

Që avokatët ta kuptojnë se komunikimi me institucione bëhet vetëm përmes rrugës zyrtare

Që avokatët çdo komunikim ta paraqesin zyrtarisht dhe në forma të shkruara

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditorë

4.8. PËRFAQËSIMI DHE MBROJTJA JURIDIKE

HYRJE

Ky modul ka për qëllim që avokatët të kenë të qartë se përfaqësimi i palëve është metodë specifike dhe se dallon nga rasti në rast dhe nga procedura në procedurë. Përmes këtij moduli mundohet të arrihet qëllimi se avokati duhet ta përfaqësoj palën jo domosdo në të gjitha çështjet në të cilat pala kërkon.

OBJEKTIVAT

Të kuptojnë përmbajtjen e Kodit të Etikës profesionale, Rregullores për procedurën Disiplinore;

Të zbatojnë në praktikë ndryshimet e Kodit të Etikës Profesionale dhe Rregullores për procedurën Disiplinore;

Të zbatojnë drejtë tarifën e OAK-së dhe të kuptojnë drejtë mënyrën e përpilimit të listës së shpenzimeve

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditore

4.9. NDIHMA JURDIKE

HYRJE

Ky modul për qëllim që avokatët të arrijnë njohuritë dhe dallimet në mes të angazhimeve sipas detyrës zyrtare dhe Pro Bono. Derisa Ex officio është angazhim i cili ka shpërblim nga institucioni që e cakton avokatin dhe se i njëjti i nënshtrohet rregullave dhe obligimeve që i përcakton institucioni që ka caktuar avokatin. Kurse angazhimi **pro bono** është obligim normativë i avokatëve të cilat janë anëtarë të OAK-së dhe i njëjti është pa pagesë.

OBJEKTIVAT

Të kuptojnë dhe zbatoj përmbajtjen e Kodit të Etikës profesionale, Rregullores për procedurën Disiplinore;

Të zbatojnë drejtë tarifën zyrtare Ex officio të institucionit .

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditore

4.10. REKLAMIMI DHE KËRKIMI I KLIENTËVE

HYRJE

Ky modul ka për qëllim që të informoj avokatët me kufizimet që janë të detyruar ti respektojnë se reklamimi i avokatëve në çfardo forme është i ndaluar .Po ashtu edhe kërkimi i klientëve në çfardo mënyre të publikimit të shërbimeve që ofrohen është i ndaluar.Ky parim kohëve të fundit është bë një dukuri negative ku avokatët në zyrat e tyre kanë reklama tërheqëse jashtë standardëve normative, e po ashtu në rrjete sociale të njejtit bëjnë publikime mbi shërbimet që i ofrojnë. Andaj është e rëndësishme që ky lloj trajnimi ti njoftoj avokatët lidhur me reklamimin.

OBJEKTIVAT

Që avokatët nuk duhet të kenë hapësira reklamuese përpos hapësirës së përcaktuar me rregullore.

Që avokatët të mos bëjnë ofertime për shërbimet të cilat i ofrojnë .

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditore

4.11. SHPENZIMET DHE TARIFA

HYRJE

Ky modul ka për qëllim që avokatët të marrin njohurit për shpenzimet e procedurës gjyqësore si dhe aplikimit të tarifës së OAK-së. Përmes këtij moduli duhet të sqarohet mënyra dhe forma e realizimit të shpenzimeve të avokatëve si dhe mënyra dhe forma e tarifimit të shpenzimeve nga ana e Avokatëve. Është rëndësishme që avokatët ta kuptojnë se mos respektimi i rregullorës për tarifatat konsiderohet shkelje disiplinore.

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditore

4.12. SJELLJA NË JETËN PRIVATE NDËRLIDHUR ME PROFESIONIN E AVOKATIT

Ky modul ka për qëllim që avokatët të njoftohen lidhur me detyrimet e tyre të cilat i përcjellin edhe gjatë jetës së tyre private. Kohëve të fundit shume avokatë janë pjesë e debateve të

ndryshme në mjetet e informimit ku tema që ata trajtojnë nuk është temë që lidhet me profesionin e avokatit , prandaj shpesh herë paraqitja e tyre nuk është në përputhje me etikën e avokatit, andaj kjo krijon dhe cenon prestigjin dhe imazhin e profesionit të avokatit.

OBJEKTIVAT

Që avokatët të kuptojnë se profesioni i tyre në disa raste ja kufizon lirinë personale

Që sjellja e tyre në jetën private ka implikime edhe në punën e tyre profesionale

Që ata nuk mundën të paraqiten në cilësinë e avokatit ne media duke trajtuar tema personale apo të grupeve të caktuara të interesit.

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditore

4.13. RAPORTET E AVOKATËVE ME AVOKATËT

HYRJE

Ky modul ka për qëllim që avokatët të marrin njohurit e nevojshme për raportet kolegjale që avokatët duhet ti krijojnë me avokatët, qoftë në raport kur janë palë në pozicione të kundërta, apo në pozicione tjera. Nga praktika shpesh herë paraqiten raste kur klienti për arsye personale apo të interesit të tij dëshiron ta ndërroj avokatin e përcaktuar më parë, pa e njoftuar avokatin paraprak, apo pa e njoftuar avokatin e ri se më parë kishte avokat, andaj ky modul do të përpiket të përcaktoj parimet bazë të komunikimit kolegjial.

OBJEKTIVAT

Të kuptojnë raportet etike profesionale të bashkëpunimit.

Përfituesit: avokatët

Kohëzgjatja: Një ditore

4.14. ZHVILLIMI I SHKATHTËSIVE TË PËRFAQËSIMIT GJATË GJYKIMIT

Ky modul ka për qëllim që avokatët të fitojnë njohuritë mbi shkthtësit praktike lidhur me prezantimin dhe administrimin e provave, metodave të marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe prezantimin e rasteve në gjykatat ku ata përfaqësojnë .

Ndryshimet e fundit të kodit të procedurës penale lidhur me mënyrën e marrjes në pyetje dhe prezantimin e provave si dhe udhëheqjen e shqyrtimit gjyqësor inponojnë nevojën që avokatët të ngrisin shkathhtësinë profesionale të përfaqësimit gjatë gjykimit .

Në menyrë të veçantë duhet të bëhet ngritja e shkalltësive që në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndërlidhet me: fjalën hyrëse, marrjen e drejtë për drejtë dhe të tërthorët dhe fjalën përfundimtare .

OBJEKTIVAT

Avokatët pas përfundimit të këtij trajnimi do të jenë në gjendje :

Të zbatojnë drejtëpërdrejtë dispozitat e kodit të procedurës penale lidhur me fjalën hyrëse, marrjen në pyetje të drejtëpërdrejtë dhe të tërthorët si dhe fjalën përfundimtare.

Të bëjnë dallimin e qartë të marrjes në pyetje të drejtëpërdrejtë dhe të tërthorët si dhe fjalës hyrëse dhe asaj përfundimtare

Të indentifikojnë të metat kryesore të cilat e bëjnë dhe të informohen për strategjinë dhe efikase të përfaqësimit apo mbrojtjes .

Në kuadër të këtij trajnimi do të trajtohen çështjet si vijon

Fjala hyrëse

Marrja e drejtëpërdrejtë në pyetje

Marrja e tërthorët në pyetje

Vënia në dyshim

Riekzaminimi dhe rehabilitimi

Rimarrja në pyetje të tërthortë

Fjala përfundimtare

Kohëzgjatja e trajnimit 1 deri në 3 ditë

Përfituesit: Avokatët